




Hapsira për reklamën tuaj

[Hyrje](#) | [LAJME](#) | [Kulturë](#) | "Fluturimi mbi teatrin e Kosovës" në Shkup

"Fluturimi mbi teatrin e Kosovës" në Shkup

Madhesia e gervave:

29/03/2013 11:13:00



"Fluturimi mbi teatrin e Kosovës" është një komedi politike mbi një rën nga ngjarjet më të rëndësishme globale të këtij shekulli – lindjen e shtetit të Kosovës

Të premten më 29 mars, në Qendrën Teatrore për Fëmijë, Qendra Multimedia nga Prishtina prezenton komedinë patriotike "Fluturimi mbi teatrin e Kosovës", të autorit Jeton Neziraj. Luajnë aktorët: Bajrush Mjaku, Adrian Morina, Anisa Ismaili, Adrian Aziri dhe Ernest Malazogu.

Kjo komedi vjen sërish në Shkup pas premirës në Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe prezentimeve në Teatrin Kombëtar të Shqipërisë, Qendrës për Dekontaminim Kulturorë në Beograd.

Shfaqja është pritur shkëlqyeshëm dhe për të kanë shkruar edhe mediat ndërkombëtare, përfshi "La Repubblica" (Itali), "Theater Heute" (Gjermani) e Strada (Francë).

Gati dhjetë vite pas përfundimit të luftës, Kosova, që deri atëherë po administrohej nga misioni i Kombeve të Bashkuara, bëhet gati të shpallë pavarësinë. Shteti më i ri në botë pritet të lindë pas pak. Sekretari i Ministrisë së Sportit kërkon nga trupa e Teatrit të Kosovës që të përgatisin një shfaqje teatrore solemne e cila do të jepet ditën historike të shpalljes së pavarësisë. Për festën e pavarësisë janë ndarë 2 milion euro. Trupa e teatrit ndjehen të privilegjuar dhe krenarë. Por ky ngazëllim ka edhe sfidat e veta. Pas ca kërkesave "estetike", politikisht korrekte, trupa përballat edhe me dy "problemthe" të paparashikueshme. I pari, dita kur duhet të shpallet pavarësia mbahet sekret dhe i dyti, në shfaqje duhet të përfshihet edhe fjalimi ende i pashkruar i Kryeministrit, të cilin ai do ta mbajë në parlament në ditën historike.

Dhe derisa ekipi i teatrit fillon provat intensive, Xhejmsi, tekniku i skenës ka një projekt paralel. Ai fillon të konstruktojë një aeroplan me të cilin dëshiron të fluturojë rreth globit me qëllim që, në këtë mënyrë origjinale, të llojë në shumë shtete të botës për njohje të shtetit të ri.

Lajmi për datën e shpalljes së pavarësisë vjen papritur. Në mbremje, kabineti qeveritar, mysafirë nga NATO, UN, EU dhe diplomatë të tjerë, vijnë në Teatrin e Kosovës për të parë shfaqjen – epopenë kombëtare të Kosovës.

"Fluturimi mbi teatrin e Kosovës" është një komedi politike mbi një rën nga ngjarjet më të rëndësishme globale të këtij shekulli – lindjen e shtetit të Kosovës.

Kjo është një komedi për Kosovën e re që, e lodhur dhe e rrënuar nga lufta, varfëria, korrupsioni dhe tutelat e pafundme të misioneve ndërkombëtare, përpiket ta gjejë rrugën e vet drejt të ardhmes...

Regjia: Blerta Neziraj

Muzikantë: Susanna Tognella (violinë) dhe Gabriele Marangoni (harmonikë),

dramaturg dhe bashkëpunëtor artistik: Ilir Gjocaj,

koreografia: Arthur Kuggeleyn,

kompozitor: Gabriele Marangoni,

skenografia dhe kostumet: Susanne Maier-Staufen.

Producent: Qendra Multimedia

Producent ekzekutiv: Jeton Neziraj

Menaxhere e skenës: Sunita Kurti

Realizimi i skenografisë: Kërste S. Xhidrov

Asistente e kostumografisë: Leonora Mehmeti

Ndriçimi: Skënder Latifi, Ibrahim Xhemali

Komente (0 publikuar):

total: | Treguar:

Publikoni komentin tuaj

Emri juaj:

e-mail adresa e juaj:

Faqja e juaj në internet:

Shtoni komentin tuaj: